

Masa urgjente dhe të jashtëzakonshme për të ndihmuar në pagesën e qirasë pas urgjencës epidemiologjike Covid-19. Publikimi i listës së përkohshme të aplikimeve të pranuarra dhe atyre të përjashtuara.

Ju njoftojmë që është publikuar, sipas vendimit ekzekutiv nr. 333 të 28/05/2020, dhe modifikuar me vendim ekzekutiv n. 335 datë 01/06/2020, **lista e përkohshme e aplikimeve të pranuarra dhe atyre të përjashtuara** nga pjesëmarrja në Njoftimin për kontributin e jashtëzakonshëm dhe urgjent të pagesës së qirasë për Covid19.

Ankesat kundër listës me të përjashtuarit apo dhe kundrejt korigjimeve të vlerës I.S.E. që iu është caktuar, mund të paraqiten vetëm nëpërmjet faqes online [F.I.D.O.](#) brënda orës 24.00 të datës **10 qershor 2020**.

Bëjmë me ditur gjithashtu se, në bazë të ligjit në fuqi mbi mbrojtjen e privatësinë, nuk mund të publikohen emrat e personave, por do të publikohet vetëm numri i protokollit që iu është dhënë në momentin e aplikimit nga faqja F.I.D.O. (**Kujdes!** numëri i protokollit dhe jo i aplikimit).

Në listën e të **pranuarve** pranë çdo numëri protokollit është shënuar vlera I.S.E e të gjithë trungut familjar (**Kujdes!** është I.S.E dhe jo I.S.E.E); ju këshillohet ta kontrolloni dhe në rast gabimi të bëni një ankesë për korigjim.

Në listën e të **përjashtuarve**, gjithnjë pranë numërit të protokollit do të gjeni shpjegimin me arsyet e këtij vendimi; ju këshillohet t'i lexoni me kujdes dhe në rast të kundërt të bëni ankesë për plotësim dokumentacioni apo korigjim të saj, aty ku është e mundur.

Nëse keni nevojë për më shumë informacione mbi situatën tuaj mund të shkruani një e-mail në adresën serv.soc@comune.campi-bisenzio.fi.it i duke shënuar **numërin e protokollit** ose të bashkangjitni kopje të aplikimit (të marrë më parë në adresën e e-mailit).

Kush dëshiron të bëjë ankesë, u këshillohet të paraqesë sa më parë dokumentacionin e nevojshëm ku tregohet ulja e vërtetë e të ardhurave për vitin 2020, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019, për shkak të emergjencës Covid19 (si për shembull, kush është i regjistruar për pagesën e papunësisë, ulje në orët e punës, mbyllje apo ndërprerje të punës etj..):

- letër pagese (buste paga) për punëtorët e punësuar;
- fatura ose hyrjet tremujorëshe për të vëtpunësuarit.

Këto dokumentacione mund të dërgohen në adresën: serv.soc@comune.campi-bisenzio.fi.it ose nëpërmjet faqes online: [#IoRestoaCasa e uso F.I.D.O.](#)

Konsulto listën e të pranuarve [Consulta Elenco ammessi fascia A e fascia B \(ordine crescente\) \(20.8 KB\)](#)

Konsulto listën e të përjashtuarve [Consulta Elenco esclusi \(ordine crescente\) \(39.36 KB\)](#)